



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA E KORÇËS**

**Korçë, më datë 19/10/2018**

**Proces-verbal nr. 2**

Bazuar në LIGJIN Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 5- 18 tetor 2018 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të banorëve, u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me banorët e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Thanas Tona Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në qytetin e Korçës dhe Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet : Rikonstruksioni i Voskopojës, rikonstruksioni i rrugës Korçë- Erseke Loti I, Ndërtimi i “Kompleksit Multifunksional Sportiv dhe Kulturor”, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e Bashkisë Korçë, ndriçimin public, rehabilitimin e rrjetit të brendshëm rrugor në fshatrat e Bashkisë Korçë etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të banorëve për investimet gjatë vitit në vazhdim në mënyrë që t’ju jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata i shohin më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që Bashkia e Korçës duhet ti shohë me përparësi, banorët patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2019. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara sipas grafikut të takimeve të zhvilluara më poshtë.

**Takimet e zhvilluara:**

- 5 tetor 2018 Njësia Administrative Drenovë
- 9 tetor Njësia Administrative Voskop
- 10 tetor Njësia Administrative Vithkuq
- 12 tetor Njësia Administrative Bulgarec

15 tetor Njësia Administrative Dvoran  
18 tetor Njësia Administrative Voskopojë dhe Lekas

Bazuar në kërkesat e ngritura nga banorët dhe kryetarët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

### **DRENOVË**

- **Fshati Mborje:** rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, asfaltimi i rrugës së Muslinjve, Lagjia e përtejme riparim kalldrëmi, ndërtimi i unazës së fshatit dhe sistemimi i ujërave të shiut.
- **Fshati Ravonik:** rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, kanaleve kullues dhe vaditës, rikonstruksion rrugësh, vendosja në funksion e çezmës tek varrezat e fshatit, sistemimi i rrugëve të parcelave, rikonstruksioni i rrugës në hyrje të fshatit, rikonstruksioni i qendrës shëndetësore dhe rehabilitimi i fushës sportive.
- **Fshati Turhan:** rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve, kanaleve kullues dhe vaditës, rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm rrugor, shtimi i ndriçuesve publikë, ndërtimi i një qendre për moshën e tretë.
- **Fshati Drenovë:** largimi i bagëtive nga fshati.
- **Fshati Qatrom:** mbushja e rezervuarit me dhe'.

**(XXX): Në fshatin Mborje** janë të domosdoshme investimet për ujësjellësin dhe vënien në funksion të depos së ujit, rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të fshatit dhe ndërtimi i unazës së fshatit.

**(XXX): Në fshatin Ravonik** janë të domosdoshme investimet për ujësjellësin dhe vënien në funksion të kanaleve kullues dhe vaditës, rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të fshatit dhe i qendrës shëndetësore.

**(XXX): Në fshatin Ravonik** të rinjtë janë angazhuar me sport ndaj do të ishte e nevojshme rehabilitimi i fushës së sportit dhe vendosja e standartit pasi kjo do të ishte diçka shumë positive për fshatin.

**(XXX): Në fshatin Turhan** janë bërë disa ndërhyrje por ne kemi të domosdoshme investime të tjera të cilat do ta përmirësonin ndjeshëm përditshmërinë tonë. Do të ishte mirë që gjatë vitit 2019 të bëhet rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimeve, kanaleve kullues dhe vaditës, rikonstruksioni i rrjetit të brendshëm rrugor, shtimi i ndriçuesve publikë, ndërtimi i një qendre për moshën e tretë.

**(XXX): Në fshatin Drenovë** i cili është pjesë edhe e paketës së 100 Fshatrave duhet patjetër të merren masa për largimin e bagëtive nga fshati. Ne po profilizohemi drejt turizmit dhe kjo nuk i shkon imazhit të fshatit.

**(XXX): Në fshatin Qatrom** është një rezervuar i hapur para disa vitesh nga një firmë private, i cili rrezikon jetën e banorëve dhe sidomos fëmijëve, ju lutemi të merrni masa ju ose të detyroni firmën që ta mbyllë atë rezervuar.

**(XXX): Në fshatin Boboshticë** duam që depo e ujit të pastrohet dhe të vihet në funksion plotësisht dhe të furnizohen me ujë të pijshëm të gjitha familjet.

## VOSKOP

- **Fshati Voskop:** Rehabilitimi i rrugëve të parcelave, sistemimi i urës së Dunavecit, ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve
- **Fshati Polenë:** ndërtimi i ujësjellësit të rid he rrjetit të kanalizimeve, plotësimi i ndriçimit public, çakullimi i rrugës së varrezave, veshja me beton e kanaleve dytësore, riparimi i rrjetit të vaditjes në formë shiu, përcaktimi i një fondi në buxhet për grupin e karnavaleve të fshatit
- **Fshati Dërsnik:** rregullimi i trasesë së digës, ndriçimi public i lagjes Sopole, rikonstruksioni i qendrës shëndetësore të fshatit.
- **Fshati Damjanec:** Ndërtimi i rrugës së fshatit, rehabilitimi i sistemit kullues, sistemimi i rrugës së varreve, zgjidhje e problemeve me AMTP.
- **Fshati Goskovë:** ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve, përfundimi i asfaltimit të rrugës, çakullimi i rrugës së parcelave, ndriçimi publik, rikonstruksioni i kopështit, ndërtimi i një fushe sporti, çakullimi i rrugës së varrezës së fshatit.

**(XXX): Në fshatin Voskop** janë 2 rrugë parcelash që duhen sistemuar. Është rruga tek Baça e Madhe dhe rruga e Vreshtave siç i quajmë ne. Gjithashtu edhe ujrat e zeza të fshatit janë në gjendje shqetësuese ndaj ju lutem të merrni masa.

**(XXX):** Në fshatin Polene duhet të parashikohet edhe një fond për grupin e Karnavaleve dhe festën pasi është një traditë shumë e njohur e Polenës dhe duam që ta zgjerojmë aktivitetin. Përveç kësaj në sektorin e bujqësisë kemi nevojë për veshjen me beton të kanaleve dytësore dhe pastrimin e tyre si edhe riparimin e rrjetit vaditës me pika ose në formë shiu.

**(XXX): Jam banor i fshatit Dërsink.** Ne kemi ende shumë nevoja për ndërhyrje në fshat por më shqetësueset janë këto që po listoj: së pari pasi u bë ujësjellësi u dëmtuan disa nga rrugët e fshatit ndaj ato duhen rregulluar përsëri. Së dyti, ka nevojë për rikonstruksion qendra shëndetësore, duhet rregulluar traseja e digës pasi është prishur si edhe të përfundojë ndriçimi në lagjen Sopole.

**(XXX):** Në fshatin Damjanec duhet të sistemohet rruga me patjetër pasi dimri na sjell shumë problem. Gjithashtu edhe tek rruga e varreve duhet një ndërhyrje, kemi edhe problem me çertifikatat e pronësisë dhe po presim ende për këtë çështje. Një tjetër shqetësim janë edhe kabujt e shtyllave elektrike që janë shumë të varur dhe paraqesin rrezik.

**(XXX):** Jam banor i fshatit Goskovë Poshtë. Kam disa kërkesa të cilat janë shqetësim jo vetëm për mua por për gjithë komunitetin. Rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza duhet rregulluar,

rruga që u asfaltua duhet të vazhdojë edhe disa metra më tej sepse nuk e përfshiu të gjithë rrugën e fshatit si edhe ndriçimi vazhdon të ketë problem.

**(XXX):** Në fshatin Polenë janë bërë disa ndërhyrje por ka nevojë edhe për disa të tjera. Më emergjente është ndërtimi i një ujësjellësi dhe sistemimi i rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza. Gjithashtu ende kemi nevojë për disa ndriçues dhe çakullimin e rrugës së varrezave. Ju lutemi që vitin tjetër t'i shikoni me përparësi.

**(XXX):** Në fshatin Goskovë lart ka nevojë për më shumë investime. Kopështi i fëmijëve është i domosdoshëm, ujë nuk kemi, ndriçim po ashtu. Kërkojmë edhe ndërtimin e fushës së sportit dhe asfaltimin e rrugëve.

### **VITHKUQ**

- **Fshati Leshnje:** Kanalet kullues pastrim, Rrjeti I kanalizimeve, rehabilitimi i sheshit para shkollës, rikonstruksioni i qendrës shëndetësore, rikonstruksioni i shkollës së fshatit
- **Fshati Vithkuq:** ujësjellës i ri, pastrami I fshatit, sistemimi i rrugës hyrëse të fshatit.
- **Fshati Lubonjë:** rrjeti i kanalizimeve, rikonstruksioni i urës së gurit, pastrim i kanaleve kullues, ndërtimi i ujësjellësit
- **Fshati Shtyllë:** Sistemimil varrezave të fshatit, lumi paraqet rrezik nga përmytjet, sistemimi I tombinove,
- **Fshati Panarit:** sistemimi i urës së fshatit, rikonstruksioni i qendrës shëndetësore, mungesa e gjelbërimit, pastrimit dhe ndriçimit.,zgjidhja e transportit për fëmijët e shkollës

**(XXX):** Jam banor i fshatit Vithkuq. Ne përballemi me disa probleme të ujit të pijshëm, në fshat ka disa vatra me mbetje të cilat duhen pastruar ndërsa rruga hyrëse e vithkuqit ka mbetur e pandërtuar.

**(XXX):** Në fshatin Shtyllë kemi ende nevojë për disa tombino, gjithashtu lumi i fshatit rrezikon që të shkaktojë përmytje dhe duhet pastruar dhe sistemuar.

**(XXX):** Në fshatin Panarit qendra shëndetësore është në kushte shumë të këqija. Në fshat mungon edhe pastrami, ndriçimi dhe gjelbërimi. Janë shërbime që duhet t'i përfitojë edhe fshati ynë.

### **VOSKOPOJË DHE LEKAS**

- **Fshati Gjonmadh:** Ujësjellësi I fshatit, rruga kryesore ka nevojë për rikonstruksion
- **Fshati Lavdar:** Mungesa e ndriçimit, mungesa e kanalizimeve, problem me infrastrukturen
- **Fshati Voskopojë:** Ndërtimi i shkollës dhe kopshtin, problem me AMTP
- **Fshati Shpiskë:** Mungesa e kanalizimeve dhe ndërhyrje në rrjetin rrugor të fshatit.

(XXX): Jam banor I fshatit Voskopojë. Shqetësim kemi fushën e sportit. Ndërhyrja që u bë ka disa mangësi dhe do të donim që të sistemohej edhe pak. Një tjetër shqetësim është edhe sigurimi I druve të zjarrit për ngrohje. Këtu dimri është shumë i ftohtë dhe do të donim që të na e zgjidhni këtë pjesë si do të procedojmë.

(XXX): Jam banore e Voskopojës, vazhdojmë të kemi probleme me çertifikatat e pronësisë.

(XXX): Voskopoja është orientuar drejt turizmit. Për ne mbetet pak e vështirë pjesa e ndërtimeve. Unë kam një tokë në pronësi dhe dua të ndërtoj por nuk më lejhoet për shka të vijës së verdhë. Në të ardhmen a do të ketë një rishikim të planit rrekullues?

(XXX): Në fshatin Gjonomadh janë bërë shumë pak ndërhyrje. Për vitin 2019 do të donim që në buxhet të parashikohej ndërtimi I ujësjellësit të fshatit, rikonstruksioni i rrugës kryesore të fshatit por edhe sistemimi i qendrës së fshatit.

(XXX): Në fshatin shipskë ka nevojë për rrugë, kanalizime por edhe për disa investime të tjera. Është e domosdoshme që të ecet pak më shpejt edhe me çështjen e marrjes së çertifikatave të pronësisë.

(XXX): Jam kryeplaku I fshatit Lavdar. Në pjesën e ndriçimit public kemi disa rrugë që janë në terr të plotë, fshati ka mungesë të kanalizimeve dhe problem me ujin e pijshëm. Gjithashtu edhe në disa prej parcelave duhen rregulluar rrugët pasi fermerët kanë problem për të hyrë në tokat e tyre.

(XXX): Jam banor I Lekasit. Shqetësimin kryesor e kemi për energjinë elektrike. Jo vetëm që në shtëpitë tona ka problem por edhe në fshat kemi nevojë për ndriçim pasi rrugët janë në errësirë të plotë. Gjithashtu rruga ka problem dhe në dimër është e vështirë të kalohet. U bë një pjesë dhe do të donim që të përfundonte rikonstruksioni I plotë.

## **DVORAN**

- **Fshati Ujëbardhë:** ujësjellës I ri për fshatin, rikonstruksioni I rrugëve dhe vendosja e ndriçuesve
- **Fshati Dvoran:** Heqja e bagëtimeve
- **Fshati Floq:** ndërtimi I ujësjellësit të ri ose rikonstruksioni I rrjetit ekzistues
- **Fshati Kamenicë:** ndërtimi I rrjetit të kanalizimeve, vaditja e tokave
- **Fshati Pulahë:** rehabilitim I rrugëve të parcelave dhe ujësjellës I ri

**Apostol Bello:** Në fshatin Ujëbardhë janë të domosdoshme investimet për ujësjellësin dhe vënien në funksion të depos së ujit, rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të fshatit dhe përmirësimi I ndriçimit public.

**(XXX):** Në fshatin Kamenicë lagjia e vjetër siç njihet nga banorët, ka nevojë sistemimin e rrjetit të kanalizimeve, ndriçimin publik i cili është realizuar pjesërisht si dhe ngritjen e një motopompe për vaditjen e tokave bujqësore. Është një sipërfaqe prej 30 Ha e cila do të vaditej pa problem nëse kjo gjë do të realizohej. Edhe qendra shëndetësore është shumë e amortizuar.

**(XXX):** Unë jam nga fshati Floq. Së pari ne kemi të domosdoshme sistemimin e kabinës elektrike sepse është e hapur dhe përbën rrezik për fëmijët e fshatit si dhe t'i jepet zgjidhje problemit të ujit të pijshëm.

**(XXX):** Jam kryeplaku i fshatit Dvoran. Në fshatin tonë janë bërë shumë investime por ka nevojë edhe për disa të tjera. Së pari ne kemi të domosdoshme zgjidhjen e problemit të menaxhimit të depos së ujit. Furnizimi bëhet me orar por personat që e menaxhojnë vijnë nga Korça dhe në shumë raste në darkë ose nuk e hapin ose në rastet kur e hapin e lenë gjithë natën, duhet të zgjidhet ky problem. Gjithashtu duhet të vazhdoni edhe nismën që morrët për largimin e bagëtive nga fshati. Nuk mund të vazhdojnë të lihen kështu, tufa me bagëti dhe qentë e kopeve në mes të fshatit, kemi frikë të dalim nga shtëpia. Një tjetër problem që kërkon zgjidhje është edhe zyra e këshillit, ne nuk kemi zyrë këshilli dhe duhet ndërtuar.

**(XXX):** Në fshatin Pulahë ku unë jetoj problem mbetet uji i pijshëm pasi rrjeti është i amortizuar, duhet të ndërhyet edhe në disa rrugë mes parcelave në mënyrë që të gjithë fermerët të kenë mundësi të shkojnë në tokat e tyre.

## **BULGAREC**

**(XXX):** Në fshatin Bulgarec ka nevojë për sitemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të përdorura, një pjesë e rrugëve janë bërë me asfalt ndërsa pjesa tjetër jo si dhe ti jepet zgjidhje furnizimit me ujë të pijshëm.

**(XXX):** Unë jetoj në fshatin Biranj. Në Biranj investimet që duhet të keni parasysh janë: asfaltimi i rrugëve, rrjeti i kanalizimeve, ndriçimi, dhe sistemimi i përroit i cili kalon në mes të fshatit.

**(XXX):** Unë jam kryeplaku i fshatit Belorta. Në emër të banorëve më lejoni t'iu kërkoj që tu jepni zgjidhje këtyre problemeve. Problemi i ujit të pijshëm mund të zgjidhet me dy shpime deri në 50 m thellësi, njëra nga lagjet ka nevojë për sistemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të përdorura edhe shkolla ka nevojë për rikonstruksion. Vijnë fëmijët e 3 fshatrave në shkollën tonë ndaj ju lutem të merrni masa.

**(XXX):** Jam kryeplaku I fshatit Çiflig. Ato për të cilat ne kemi nevojë që ju të investoni janë: 1. Rrjeti I kanalizimeve, 2. Tokat tona janë pa ujë duhet të rregulloni kanalet vaditës, 3. Rikonstruksioni I shkollës së fshatit.

**(XXX):** Jam kryeplaku I fshatit Kuç. Në fshatin tonë janë bërë ndërhyrje, disa janë në vazhdim si sitemimi I rrugëve mes parcelave, rrjeti vaditës dhe kullues është rehabilituar por kemi edhe disa punë të papërfunduara. Fusha e sportit dhe sitemimi I pjesës së varrezave të fshatit.

Drejtore e Marredhenieve me Publikun  
dhe Informimin Qytetar:  
Larisa Katundi